




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë **25.01.2023**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.01.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik AI Group PRO SH.P.K.; Lekaj.ING SH.P.K.; ZEROLINE SH.P.K.**, 10000, Prishtinë, Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i projekteve detale 3 llote”**, me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Grup i Operatorëve Ekonomik AI Group PRO SH.P.K.; Lekaj.ING SH.P.K.; ZEROLINE SH.P.K e datës 23.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve detale 3 llote”, me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 17.01.2023 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Anulohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për:

Llot 1 Grupin e operatorve ekonomik Eng group shpk& Master architects shpk Prishtine,

Llot 2 Studio Hapsira shpk & Taulant shpk Prishtine,

Llot 3 Grupi i operatorëve ekonomik Infra- Plus shpk& Alb architect shpk Prishtine, të publikuar me datë: 17.01.2023 dhe lënda kthehet në Rivlersim;

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ta kthejë lëndën në Rivlersim për aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik Al Group PRO SH.P.K.; Lekaj.ING SH.P.K.; ZEROLINE SH.P.K** më datë 23.01.2023 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve detale 3 llote", me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 për **shpërblim me kontratë, për:**

Llot 1 Grupin e operatorve ekonomik Eng group shpk& Master architects shpk Prishtine,

Llot 2 Grupi i operatoreve ekonomik Studio Hapsira shpk & Taulant shpk Prishtine,

Llot 3 Grupi i operatoreve ekonomik Infra- Plus shpk& Alb architect shpk Prishtine, të datës 17.01.2023 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.


Autoriteti Kontraktues, me datë 24.01.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit